

REPubLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 7680 Prot.

Tiranë, më 06.10.2015

**U DH Ë Z I M**

Nr. 38, datë 06.10.2015

**PËR  
PROCEDURAT E LËVIZJES PARALELE, EMËRIMIT DHE LARGIMIT  
NGA PUNA TË MËSUESIT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE  
TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

**KREU 1**

**TË PËRGJITHSHME**

1. Procedurat për emërimin dhe largimin nga puna të mësuesit administrohen nga njësitë arsimore vendore, institucionet arsimore e përfaqësues të prindërve dhe udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizimit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve.
2. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur.
3. Procesi i konkurrimin për emërimin e mësuesit zhvillohet për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit.
4. Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurrimin, i cili zhvillohet në tri faza:
  - a. Konkurrim me dosje.

- b. Konkurririm nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”.
- c. Zgjedhje e vendit të punës.

## KREU 2

### KONKURRIMI ME DOSJE

1. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit dërgojnë në njësitë arsimore vendore, ku dëshirojnë të punësohen (pa kufizim), dosjen e aplikimit për konkurrim. Dosja e aplikimit dërgohet në njësinë arsimore vendore përmes shërbimit postar, brenda afateve të përcaktuara nga njësia arsimore vendore.
2. Dosja e aplikimit për mësues përmban:
  - a) Curriculum Vitae sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
  - b) Raport mjeko-ligjor (i tre muajve të fundit dhe i detyrueshëm).
  - c) Deklaratë për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
  - d) Vërtetim të qendrës së banimit (i detyrueshëm).
  - e) Fotokopje të librezës së punës.
  - f) Fotokopje të diplomës dhe vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli I+II dhe DIND), të noterizuar (i detyrueshëm).
  - g) Fotokopje të licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.
  - h) Fotokopje e certifikatave të trajnimeve (paraqiten kopje të certifikatave të akredituara nga MAS dhe ato jashtë vendit).
  - i) Fotokopje e dëshmimeve të shkallëve të kualifikimit.
  - j) Fotokopje të noterizuar të dëshmimeve të kualifikimeve shkencore, (gradë ose titull akademik/shkencor).
  - k) Fotokopje të dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja, të noterizuar.
  - l) Botime, kumtesa dhe publikime në fushën e edukimit. Kopje të faqes së parë, ku identifikohet titulli dhe njësia publikuese.
  - m) Deklaratë nga kandidati për autorizimin e njësisë arsimore vendore që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura (sipas shtojcës 2).
3. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, s’kualifikohet nga të gjitha fazat e konkurrimin.
4. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve për ushtrimin e profesionit si mësues, përcaktohet në shtojcën 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
5. Komisioni, brenda pesë ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, harton listën për çdo profil/lëndë dhe rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i dosjeve. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Renditja bëhet publike nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë arsimore

vendore, ku kandidatët identifikohen me kod personal. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit në njësinë arsimore vendore, brenda tri ditëve punë nga dita e shpalljes lidhur me këtë vlerësim dhe renditje.

### **KREU 3**

#### **KONKURRIMI NËPËRMJET TESTIMIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË” DHE RENDITJA PËRFUNDIMTARE**

1. Në testimin “Mësues për Shqipërinë” marrin pjesë të gjithë kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit nga vlerësimi i dosjes.
2. Aplikimi për pjesëmarrje, mënyra e testimit dhe vlerësimi përcaktohen në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Komisioni, brenda pesë ditëve pune pas marrjes së rezultateve të testimit “Mësues për Shqipërinë” nga IZHA/MAS, harton listën e kandidatëve për çdo profil/lëndë dhe rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara në testim. Rënditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Komisioni publikon listën.
4. Komisioni, pas përfundimit të afateve të ankimimit, bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin “Mësues për Shqipërinë”. Kjo renditje e përgjithshme bëhet për çdo profil/lëndë, sipas totalit të pikëve të grumbulluara. Rënditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.
5. Rënditja e kandidatëve publikohet brenda ditës në mjediset e njësisë arsimore vendore dhe në faqen zyrtare (web) të saj.

### **KREU 4**

#### **PROCEDURA E ZGJEDHJES SË VENDIT TË PUNËS DHE EMËRIMI I MËSUESIT**

1. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme sipas profilit/lëndës është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet arsimore.
2. Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës.
3. Komisioni dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat.

4. Kandidati emërohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë individuale pune me afat një vit kalendarik (periudhë prove). Kontrata nënshkruhet ndërmjet mësuesit dhe drejtorit të institucionit arsimor.
5. Drejtori i institucionit arsimor, në përfundim të kontratës individuale, pas miratimit të këshillit të prindërve të institucionit arsimor dhe komisionit të shërbimit psiko-social, komision i cili ngrihet nga drejtuesi i njësisë arsimore vendore, bën emërimin definitiv të mësuesit. Vendimi për emërimin e mësuesit i dërgohet njësisë arsimore vendore.
6. Në rastet kur vlerësimi i këshillit të prindërve apo i komisionit të shërbimit psiko-social nuk është pozitiv për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga mësuesi gjatë periudhës së provës, drejtori i institucionit arsimor ndërpret marrëdhëniet e punës me mësuesin.
7. Kandidatët nuk mund të refuzojnë më shumë se tri vende pune të lira në tri njoftime të njëpasnjëshme të komisionit. Në rast se refuzojnë më shumë se tri vende, kandidatët hiqen nga lista e renditjes.
8. Për një vend të lirë pune me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme, komisioni është i detyruar të njoftojë në fillim kandidatët për mësues që janë të punësuar në një vend pune me ngarkesë të pjesshme apo të përkohshme. Mosofrimi i vendeve sipas kësaj pike bën të pavlefshme kontratën e punës të lidhur me kandidatët e tjerë.
9. Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. Kandidati i punësuar sipas kësaj pike, nuk e humbet të drejtën për t'u njoftuar për të zgjedhur, sipas këtij kreu, si dhe ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës përpara afatit.

## **KREU 5**

### **NGRITJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE PËRGJEGJËSITË**

1. Për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve për mësues, për të tri fazat, drejtuesi i njësisë arsimore vendore krijon Komisionin e Vlerësimit.
2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga:
  - a) Një përfaqësues i njësisë arsimore vendore, që mbulon çështjet e kurrikulës (kryetar).
  - b) Katër mësues me kualifikim "Mjeshtër", që përfaqësojnë katër fusha të ndryshme lëndore nga e njëjta njësi arsimore vendore (anëtarë).
  - c) Dy përfaqësues të prindërve të zgjedhur ndërmjet kryetarëve të këshillave të prindërve (anëtarë).
  - d) Një punonjës psiko-social nga e njëjta njësi arsimore vendore (anëtar).

3. Komisioni asistohet nga grupe teknike të përcaktuara me urdhër të drejtorit të njësisë arsimore vendore, sipas kërkesave të komisionit.
4. Anëtarët e komisionit dhe të grupeve teknike duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët (shtojca 4).
5. Komisioni është përgjegjës për:
  - a) Administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët për mësues.
  - b) Vlerësimin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim.
  - c) Renditjen e kandidatëve për çdo profil/lëndë, mbi bazën e vlerësimit të dosjes dhe shpalljen e renditjes në faqen zyrtare web dhe në mjediset e njësisë arsimore vendore.
  - d) Renditjen e kandidatëve për çdo profil/lëndë, mbi bazën e vlerësimit të testimit "Mësues për Shqipërinë" dhe shpalljen e renditjes në faqen zyrtare web dhe në mjediset e njësisë arsimore vendore.
  - e) Renditjen e përgjithshme për çdo profil/lëndë të kandidatëve në nivel të njësisë arsimore vendore dhe shpalljen e renditjes së përgjithshme në faqen zyrtare web dhe në mjediset e njësisë arsimore vendore.
  - f) Vlerësimin dhe renditjen e mësuesve, sipas pikëve të marra nga vlerësimi i dosjeve, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore.
  - g) Monitorimin e punësimeve sipas renditjes së përgjithshme të kandidatëve dhe raportimin në MAS, çdo tre muaj.
  - h) Njoftimin e përfaqësuesve vendorë të sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës, për pjesëmarrje në mbledhje dhe për monitorimin e të gjithë procesit të konkurrimit dhe të emërimeve.

## **KREU 6**

### **ANKIMIMI**

- 1 Çdo kandidat ka të drejtën të ankimojë vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit.
- 2 Ankimimi i kandidatit protokollohet në njësisë arsimore vendore brenda tri ditëve pune nga shpallja e akteve të komisionit.
- 4 Ankimiet shqyrtohen nga drejtuesi i njësisë arsimore vendore, në bashkëpunim me komisionin përkatës, brenda tri ditëve pune. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimuesit me shkrim nga njësia arsimore vendore.
- 5 Vendimi i njësisë arsimore mund të ankimohet në MAS.

## KREU 7

### SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR LËVIZJE PARALELE, LËVIZJE PARALELE TË DETYRUESHME DHE ULJE NË DETYRË

1. Të gjithë mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, bëjnë kërkesë në njësinë arsimore vendore për lëvizje paralele të detyrueshme. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 3 dhe shtojcën 3.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Të gjithë mësuesit që dëshirojnë të kryejnë lëvizje paralele brenda së njëjtës njësi arsimore vendore, paraqesin me shkrim kërkesën e tyre në njësinë arsimore vendore, brenda muajit maj. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 3 dhe shtojcën 3.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Komisioni i Vlerësimit në njësinë arsimore vendore, brenda muajit gusht, bën vlerësimin e dosjeve dhe rendit mësuesit sipas pikëve në profil/lëndë. Renditja fillon me mësuesit me më shumë pikë që janë për lëvizje paralele të detyrueshme, vijon në rend zbritës dhe më pas vijon me mësuesit me më shumë pikë që dëshirojnë të kryejnë lëvizje paralele, duke vijuar në rend zbritës. Renditja e mësuesve shpallet në web dhe në mjediset e njësisë arsimore vendore. Mësuesit kanë të drejtën e ankimit në njësisë arsimore vendore, brenda tri ditëve punë nga dita e shpalljes lidhur me këtë vlerësim dhe renditje.
4. Mësuesi, i cili në renditjen sipas profilit/lëndës është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet arsimore. Ky kandidat ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës.
5. Komisioni dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo mësues.
6. Mësuesi emërohet në mënyrë definitive nga drejtori i institucionit arsimor.
7. Të gjithë mësuesit që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, largohen nga puna me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.
8. Të gjithë mësuesit që kanë kërkuar lëvizje paralele dhe nuk janë sistemuar, vijojnë punën në institucionin arsimor ku janë.

9. Drejtuesit e njësive arsimore vendore nuk mund të pranojnë dorëheqjet e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, pa i sistemuar më parë në vende pune të përhershme dhe me ngarkesë të plotë, brenda së njëjtës njësi arsimore vendore, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, me kërkesën për sistemim si mësues, i paraqiten menjëherë Komisionit të Vlerësimit, i cili ia propozon kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës.
10. Drejtorëve dhe nëndrejtorëve të dorëhequr nga funksioni u bëhet emërim i përhershëm.

## KREU 8

### PEZULLIMI DHE LARGIMI I MËSUESIT NGA PUNA

1. Drejtori i institucionit merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, kur ndaj mësuesit zhvillohet një proces penal dhe/ose administrativ.
2. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose largimit nga detyra. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.
3. Mbarimi i marrëdhënies së punës së mësuesit me institucionin publik të arsimit parauniversitar bëhet:
  - a) kur jep dorëheqjen;
  - b) kur mbush moshën e pensionit;
  - c) kur bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore;
  - d) kur dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;
  - e) kur merret masa disiplinore e largimit nga puna;
  - f) kur institucioni shkollor nuk ofron ngarkesë mësimore lëndore.
4. Drejtori i institucionit arsimor fillon procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar në rastet e mëposhtme:
  - a) Ka falsifikuar dokumente zyrtare dhe ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit.
  - b) Ka ushtruar dhunë fizike ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit.
  - c) Ka ngacmuar seksualisht nxënës ose punonjës të institucionit.
  - d) Ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të institucionit.
  - e) Ka organizuar kurse me pagesë me nxënësit që mëson dhe me nxënësit e institucionit arsimor.
  - f) Ka organizuar kurse me pagesë me nxënës jashtë institucionit arsimor, kur nuk është i licencuar për të ushtruar këtë veprimtari private.
  - g) Ka shkelje të etikës e të sjelljes në institucion.

- h) Për mosarritje të nxënësve të tij, sipas pikës 2/c të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
  - i) Ka marrë rryshfet.
  - j) Ka ankim me shkrim nga prindër të nxënësve të atij institucioni.
  - k) Ka kryer shkelje të dispozitave të Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi.
5. Procedurat e largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar kryhen sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në legjislacionin në fuqi.

## **KREU 9**

### **IDENTIFIKIMI DHE SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

1. Njësitë arsimore vendore, në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve arsimore publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike.
2. Vendet e lira të punës, të krijuara në përfundim të vitit mësimor, u ofrohen në fillim mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, apo që kërkojnë lëvizje paralele brenda njësisë arsimore vendore.
3. Të gjitha vendet e tjera të lira të punës, apo të shpallura si të tilla gjatë vitit shkollor, trajtohen sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
4. Vend pune do të konsiderohet, çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës, e përballueshme nga një mësues në hapësirë dhe kohë, pavarësisht nëse është në një apo disa institucione arsimore. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore
5. Çdo vend i lirë pune, i paplotësuar sipas pikës 2 të këtij kreu apo i krijuar gjatë vitit mësimor, shpallet brenda dy ditëve pune në mjediset e njësisë arsimore vendore dhe të institucionit arsimor ku është vendi i lirë i punës, si dhe i njoftohet zyrtarisht Komisionit të Vlerësimit.

## KREU 10

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për të gjithë mësuesit e kontraktuar në vende pune të përhershme dhe me ngarkesë të plotë mësimore deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, drejtori i institucionit arsimor, pasi merr miratimin e këshillit të prindërve të institucionit arsimor dhe komisionit të shërbimit psiko-social të ngritur nga njësia arsimore vendore, bën emërimin definitiv të mësuesit në vendin e punës. Në rast se mendimi dhe vlerësimi janë negativë, drejtori ndërpret marrëdhëniet e punës me mësuesin dhe deklaron vendin e punës të lirë.
2. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra në zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në njësinë arsimore vendore dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.
3. Të gjithë kandidatët që kanë marrë pjesë në testimin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2014 dhe nuk janë punësuar, si dhe nuk duan të marrin pjesë në testimet e ardhshme “Mësues për Shqipërinë”, duhet të paraqesin dokumentacionin sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi në njësinë arsimore vendore, ku duan të punësohen, me qëllim vlerësimin e dosjes nga komisioni. Pas vlerësimit, këta kandidatë përfshihen në renditjen përfundimtare për profil/lëndë. Të gjithë kandidatët që nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar, hiqen nga renditja përfundimtare.
4. Udhëzimi nr. 35, datë 30.09.2014 i ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik dhe njësitë arsimore vendore.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.*

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**



**Shtojca 1**

**CURRICULUM VITAE**

**EMRI, MBIEMRI**

**DATËLINDJA:** dd/mm/vvvv

**TELEFONI:**

**ADRESA**

**E-MAIL:**

**ARSIMI:**

**SHKALLA E KUALIFIKIMIT (Nëse ka)**

**LICENCË E PROVIMIT TË SHTETIT PËR MËSUESI (Viti .....)**

**CERTIFIKATA TË AKREDITUARA. (Numrin e certifikatave dhe titujt)**

**KUALIFIKIM SHKENCOR (Grada dhe/ose titulli)**

**PUNESIMI:** Vitet dhe institucioni

**BOTIMET (Ku specifikohen botimi, kumtesa ose publikim në revista në fushën e edukimit dhe fakti nëse është autor i parë ose bashkautor)**

**GJUHË E HUAJ. Niveli/nota dhe institucioni që e ka lëshuar**

## Shtojca 2

### DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë \_\_\_\_\_, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin \_\_\_\_\_, të zhvilluar në Njësinë Arsimore Vendore \_\_\_\_\_, më datë \_\_\_\_\_, autorizoj njësinë arsimore vendore të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

AUTORIZUESI

---

### Shtojca 3

#### KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT

Nr	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor	0.5 pikë për çdo vit pune
2	Nota mesatare e studimeve të larta (cikli I+II dhe DIND) (e shprehur në numër dhe një shifër pas presjes dhjetore)	5- 10 pikë
3	<b>Kualifikimi shkencor në edukim</b> (Studime të thelluara pasuniversitare, Doktor Shkencash ose titulli shkencor)	5 pikë
4	<b>Shkalla e kualifikimit</b> Mësues i kualifikuar, 3 pikë (Shkalla III) Mësues specialist, 6 pikë (Shkalla II) Mësues mjeshtër, 9 pikë (Shkalla I)	0 -9 pikë
5	<b>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja</b> (jo mësues të gjuhëve të huaja)	0 - 3 pikë
	Dëshmi të gjuhës së huaj të fituara në IAL brenda vendit. 1 pikë	
	Dëshmi të gjuhës së huaj të njohura ndërkombëtarisht (së paku Niveli B.2) 2 pikë	
6	<b>Botimet me ISBN - 5 pikë</b>	0-7 pikë
	<b>Kumtesa, publikime - 2 pikë</b>	

### Shtojca 3.1

#### KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE NË RASTIN E NDËRPRERJES SË MARRDHËNIES SË PUNËS PËR SHKAK TË MUNGESËS SË NGARKESËS MËSIMORE.

Nr	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor	0.5 pikë për çdo vit pune
2	Nota mesatare e studimeve të larta (cikli I+II dhe DIND) (e shprehur në numër dhe një shifër pas presjes dhjetore)	5- 10 pikë
3	<b>Kualifikimi shkencor në edukim</b> (Studime të thelluara pasuniversitare, Doktor Shkencash ose titulli shkencor)	5 pikë
4	<b>Vlerësimi i komisionit psiko-social</b> Dobët 0 pikë Mjaftueshëm 1 pikë Mirë 2 pikë Shumë mirë 3 pikë	0-3 pikë
5	<b>Vlerësimi prindërve</b> Dobët 0 pikë Mjaftueshëm 1 pikë Mirë 2 pikë Shumë mirë 3 pikë	0-3 pikë
6	Vlerësimi nga drejtori i shkollës për dy vitet e fundit të punës: Dobët 0 pikë Mjaftueshëm 1 pikë Mirë 2 pikë Shumë mirë 3 pikë	0-3 pikë
7	<b>Shkalla e kualifikimit</b> Mësues i kualifikuar, 3 pikë (Shkalla III) Mësues specialist, 6 pikë (Shkalla II) Mësues mjeshtër, 9 pikë (Shkalla I)	0 -9 pikë
8	<b>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja</b> (jo mësues të gjuhëve të huaja) Dëshmi të gjuhës së huaj të fituara në IAL brenda vendit. 1 pikë Dëshmi të gjuhës së huaj të njohura ndërkombëtarisht (së paku Niveli B.2) 2 pikë	0 - 3 pikë
9	<b>Rezultati i arritur në testimin e mësuesve në sistem</b>	Pikët X 0.1
10	Botimet me ISBN - 5 pikë Kumtesa, publikime - 2 pikë	0-7 pikë

Shtojca 4

**DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN  
E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Deklaroj në përgjegjësinë time se në procesin e konkurrimit për pozicionin mësues i lëndës \_\_\_\_\_, që do të zhvillohet më datë \_\_\_\_\_, nuk jam në konflikt interesave me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

**DEKLARUESI**

\_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_,

## Shtojca 5

### DEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: \_\_\_\_\_  
(Emri, atësia, mbiemri)

Datëlindja: \_\_\_\_\_

Vendlindja: \_\_\_\_\_

Dokumenti i identifikimit: (Kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam \_\_\_\_\_  
i/e padënuar i/e denuar

Emër, mbiemër: \_\_\_\_\_ Firmë \_\_\_\_\_

**Autorizim:** Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga njësi arsimore vendore.

**Shënim.** Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".